

Z. Verçoni  
Z. Poshalci  
ni  
Gjoni



KOMISIONI I PAVARUR  
I KUALIFIKIMIT  
Nr. 1075 Prot.  
Datë, më 16. 4. 2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
SHËRBIMI LEGJISLATIV  
SHËRBIMI JURIDIK

Nr. 1179 Prot.

Tiranë, më 16. 04. 2024

Lënda: Dërgim vendimi

**KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Vendim nr. 36/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Genci GJONÇAJ**

(Në mungesë dhe me porosi)

**Merita QATO**

**DREJTORE E PËRGJITHSHME  
E LEGJISLACIONIT**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

VENDIM

Nr. 36/2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 93/2017  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS  
DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT  
TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe neneve 18, pika 1, e 29, pika 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 e vendimit të Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, i ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2023.

Miratuar në datën 11.4.2024

KRYETARE

Lindita NIKOLLA



Lidhja nr.1

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE  
TË KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

<b>FUNKSIONI ORGANIK</b>	<b>Klasifikimi i pagës</b>	<b>Numri</b>
<b>(2)</b>		
<b>I. KRYETAR</b>	G3*	1
Këshilltar pranë Mbledhjes së Komisionerëve dhe Kryetarit	II-1	1
<b>II. KOMISIONERËT</b>	G3*	(11)
<b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>	<b>(36)</b>	
Këshilltarë jurist	80% e pagës G3*	24
Këshilltarë ekonomistë	80% e pagës G3*	12
<b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>	I-1	(1)
<b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b>	<b>(15)</b>	
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	6
Specialist jurist	IV-1	2
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	2
Përkthyes	II-1	2
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II-1	1
Specialist pritje me popullin	IV-1	1
<b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>		<b>(11)</b>
Drejtor	1-4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	2

Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT **	IV-1	1
Specialist protokoll/arkivi ***	IV-1	2
Magaziniere	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/Korrier	V	1
<b>Total</b>		<b>76</b>

**Shënim:**

*\* Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".*

*\*\* Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\* Punonjësit në pozicionet specialist arkiv përfitojnë një shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\*\* Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*